



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:030391
Datë: 30.07.2021
Numri i dokumentit: 02049164

PPP.nr.07/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Durim Balaj, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit F.Q nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat në Gjilan, rruga “Bulevardi i Pavarësisë” H-35, K-II, numër 4, kundër debitorit QKMP për kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit përbarimor P.nr.1724/20 i datës 16.12.2020, i caktuar nga Zyra Përbarimore e Përbaruesit Privat G.GJ, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, jashtë seancës, me 30 korrik 2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit QKMP-Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, i paraqitur kundër urdhrin përbarimor P.nr.1724/20 i datës 16.12.2020, i caktuar nga Zyra Përbarimore e Përbaruesit Privat G.GJ për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

II. Ankesa e paraqitur nuk e ndal ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Zyra Përbarimore e Përbaruesit Privat G.GJ, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit F.Q nga Gjakova ka caktuar urdhrin për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor - Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.510/2020, datë 22.05.2020, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 09.10.2020, i cili është dokument përbarimor dhe paraqet bazë për lejimin e përbarimit sipas nenit 21 dhe 22 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit ë Procedurës Përbarimore (tutje LPP).

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor me datë 24.12.2020 prapësim ka paraqitur debitori SHSKUK - Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, në të cilin ka parashtruar se procedura përbarimore është iniciuar në kundërshtim me nenin 71 paragrafi 1, pika 1, nënpika 1.1 të LPP-së, për shkak së propozimi për përbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 144 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që akti administrativ hyn në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vet organi administrativ, i cili nxjerr këtë vendim, ndërsa QKMP, ka atakuar vendimin Nr.510, të datës 22.05.2020, të pranuar me datë 13.07.2020, sipas këshillës juridike në këtë vendim përcaktohet se pala e pakënaqur ka të

drejtë ankese në Inspektoratin e Punës në Prishtinë në afat prej 8 ditësh. Ka shtuar se meqenëse jemi pjesë përbërëse dhe organizative e SHSKUK-së, dhe si i tillë zbaton aktet ligjore sipas hierarkisë, përkatësisht veprimet e caktuara financiare në rastin në fjalë, kompensim të pagave jubilarë, jemi të varur nga ana e SHSKUK si institucion kryesor shëndetësor për njësitë organizative të nivelit shëndetësor dytësor dhe tretësor. Ka theksuar se debitori nuk posedon xhironlogari të pavarur, pasi që mjetet financiare dhe planifikimi i tyre bëhet në kuadër të planifikimeve dhe ndarjeve buxhetore brenda vijës buxhetore të SHSKUK dhe të cilat menaxhohen nga ky institucion, andaj në mungesë të linjës buxhetore QKMP nuk ka mundësi objektive për ta përmbushur obligimin e kompensimit të pagave jubilarë për faktin se veprimi në drejtim të kompensimit të pagave jubilarë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Po ashtu, ka theksuar se me Ligjin për Zyrtarët Publik, në nenin 74 paragrafi 5, parashihet se nëpunësit e shërbimit publik për çdo pakënaqësi me vendimet e organit të ankimit, gjegjësisht punëdhënësit udhëzohen ti drejtohen Gjykatës kompetente, e jo Inspektoratit të Punës, nga ku konsiderojmë që nuk është në përgjegjësinë e Inspektoratit të Punës të shqyrtoj këtë ankese lidhur me çështjen në fjalë. Me propozim për gjykatën që ta pranoj prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa propozimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim P.nr.1724/20 i datës 27.11.2020 të anulohen si të kundërligjshëm.

Kreditorja përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor me datë 30.12.2020 ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, në të cilin ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim ngase Përmbaruesi Privat me rastin e lejimit të urdhrin për përmbarim është mbështetur në vendimin nr.510/2020, datë 22.05.2020, i cili vendim është i formës se prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 02.09.2020, e me të cilin dihet saktë se në numrin rendor 45 kreditor është F.Q, ndërsa debitor është QKMP - Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës - Gjakovë, e cila është e obliguar që kreditorit të i'a paguaj pagën në shumën prej 1,663.10 euro. Lidhur me pretendimin e debitorit se akti administrativ ekzekutohet vetë kur kanë përfunduar të gjitha procedurat administrative dhe pasi që të i jepet mundësia palëve që vullnetarisht ta ekzekutojë aktin administrativ, kjo e drejtë është respektuar pasi që debitorit i është dhënë e drejta për ankese të cilën të drejtë e ka shfrytëzuar por që ankesa është refuzuar me vendimin e Inspektoratit të Punës në shkallën e dytë, duke u bërë kështu i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm vendimi Nr.510/2020 i datës 22.05.2020. Sa i përket afatit partitiv, duke u bazuar në nenin 27 par.2 i LPP-së, përmbaruesi privat i ka dhënë afat 7 ditor debitorit për përmbushje. Sa i përket pretendimit të QKMP lidhur me legjitimitetin pasiv, ky pretendim nuk qëndron nga fakti se duke u bazuar në statusin e Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës, nr.01, protokoll 05-2162 e datës 23.03.2017, të Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht neni 3 paragrafi 2 ku thuhet se "*Qendra Kombëtare te Mjekësisë së Punës është institucion shëndetësor terciar i cili e ka statusin e personit juridik publik me cilësi të autoriteti punëdhënës në të cilin organizohet, zbatohet kujdesi shëndetësor*", andaj me vetë faktin se e ka statusin e personit juridik dhe ka autoritet punëdhënës, vërteton se në cilësinë e punëdhënësit të fundit për kreditorin e fiton zotësinë e palës në procedurë dhe ka legjitimitet real pasiv. Në përgjigje në prapësim po ashtu ka theksuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit lidhur me atë se me nenin 74 paragrafi 5 të Ligjit për Zyrtarët Publik është paraparë së nëpunësit e shërbimit publik për çdo pakënaqësi me vendimet e organit të ankimit udhëzohen ti drejtohen Gjykatës kompetente e jo inspektoratit të punës, ngase për punëtorët shëndetësor aplikohet Ligji i Punës, konkretisht neni 2 paragrafi 1 dhe neni 3 paragrafi 1, nen paragrafi 1.3, ndërsa me Ligjin për Zyrtarët Publik, në nenin 2 paragrafi 4 parashihet se ky ligj aplikohet për personelin administrativ dhe nivelin e lartë drejtues të cilët punojnë në shëndetësi, e nuk zbatohet për mjekët apo infermierët të cilët kryejnë shërbime profesionale shëndetësore. Andaj bazuar në të

lartcekurat i ka propozuar gjykatës ë të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për përbarim P.nr.1724/2020 i datës 16.12.2020.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lendes, urdhrin përbarimor dhe prapësimin të paraqitur nga debitori, si dhe vlerësimin të përgjegjës në prapësim, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se caktimi i përbarimit është bërë duke u bazuar në Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.510/2020, datë 22.05.2020, me të cilin vendim është detyruar që debitori t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 1,663.10 € në emër të shpërblimit jubilar dhe atë për 20 vite të përvojës së punës.

Gjykata ka vlerësuar Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.510/2020, datë 22.06.2020, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 09.10.2020, në bazë të cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe vlerëson së ky vendim i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 paragrafi 1 pika 1.2, 23, 24 paragrafi 3 dhe 27 të LPP-së, për të qenë i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit QKMP - Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës - Gjakovë, lidhur me atë akti administrativ ekzekutohet vetëm atëherë kur kanë përfunduar të gjitha procedurat administrative dhe se në rastin konkret përbaruesi privat e ka kërkuar përbarimin e vendimit para se debitori ti shterë të gjitha procedurat administrative, mirëpo ky pretendim është i pabazuar pasi që me nenin 24 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Përbarimore është përcaktuar që *“Përbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përbarimin”*, derisa me nenin 6 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë thuhet se *“Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”*. Në rastin konkret Vendimi Nr.510/2020 i datës 22.05.2020, i lëshuar nga Inspektorati i Punës është vendim i dhënë në procedurë administrative i cili është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm me datën 09.10.2020 dhe ankesa e parashtruar nga ana e debitorit me numër 248, e datës 17.07.2020, kundër këtij vendimi, nuk e ndalon ekzekutimin e të njëjtit.

Lidhur me pretendimin e debitorit se është lejuar përbarimi pa kaluar afati vullnetar për përmbushje, gjykata bazuar në nenin 27 par.2 i LPP-së ku thuhet se *“Në qoftë se me anë të dokumentit përbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përbarimin, dhe urdhrin për përbarim, për shtatë (7) ditë”*, të njëjtin e konsideroj të pabazuar, pasi që në urdhrin për përbarim P.nr.1724/20 i datës 16.12.2020, i lëshuar nga organi përbarues - Përbaruesi Privat, është cekur afatit për përmbushje vullnetare prej 7 ditësh.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit lidhur me kompetencën e Inspektoratit të Punës për të vendosur lidhur me ankesën e kreditorit dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pambështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së tij, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimin të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi,

si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Andaj, pas vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e meqenëse debitori nuk ka ofruar prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 61 e lidhur me nenin 69 par. 4 të LPP-së, dhe nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 par 1, pika 1 deri në pikën 12 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës, kjo gjykatë vendosi që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi të pabazuar.

Gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 74 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, ku parashihet se “*Vendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përbarueshëm, e po që se kundër tij nuk lejohet ankesa, ai bëhet i formës së prerë*”, andaj mbi këtë bazë ankesa e paraqitur nuk ndalon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Për këto shkaqe dhe arsye sipas dispozitës së nenit 73 par.3 të LPP-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke refuzuar prapësimin e ushtruar ndaj urdhrin për përbarim P.nr.1724/20 i datës 27.11.2020.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.07/21, datë 30 korrik 2021.

GJYQTARI
Durim Balaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.